



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 48 /2020

Datë: 20 . 05 .2020

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7/01 mars 2019), në pajtim me nenin 30 (paragrafi 4) të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1 nën paragrafi 1.4) të Rregullores nr.05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 të Rregullores (QRK)-Nr. 17/2018 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria në detyrë e Drejtësisë nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Fadil Bunjaku, Drejtor i Drejtoratit për Punë Normativo Juridike dhe Administratë në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose Konfiskuar, emërohet Ushtrues i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose Konfiskuar.
2. Ushtruesi i detyrës sipas pikës 1 të këtij vendimi emërohet për periudhë të përkohshme në pajtim me dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi.
3. Ushtruesi i detyrës sipas pikës 1 të këtij vendimi obligohet që detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm t'i kryej në pajtim me dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Bazuar në Vendimin KD-Nr.01/2020, të datës 5 maj 2020, të Komisionit Disiplinor për Pozita të Nivelit të Lartë Drejtues, z.Rrahim Rama, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për

Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose Konfiskuar i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Me qëllim të kryerjes së detyrave dhe përgjegjësiwe të përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Albulena Haxhiu

Ministre në detyrë e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- *Z. Fadil Bunjaku;*
- *Kabinetit të Ministres;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose Konfiskuar;*
- *Arkivit të MD-së.*